



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
Trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300897/1

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë.

Drejtuar: Z. Flamur GOLEMI
Kryetar i Bashkisë

GJIROKASTËR

Znj. Reme XHOLI
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: Znj. Doriana DEMO
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

GJIROKASTËR

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë, më datë 11.10.2023 sipas Planit të Inspektimit për vitin 2023 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Lindita Dedegjoni me detyrë ndihmës komisionere të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre. Mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës tej kufijve në tejkalim të standardeve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'ju parashtrijë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon:

Objektivat e inspektimit:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e fundit si dhe gjendja aktuale;
- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e institucionit dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Gjirokastrë), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve, Gjirokastrë.

Rekomandimet e vitit 2022 dhe niveli i zbatimit të tyre,

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer më datë 09.05.2022 në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar¹:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare për eliminimin e lagështirës në ambientet e institucionit.
3. Marrjen e masave për bashkërendimin e punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksion të ngrohjes qendrore.
4. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
5. Marrjen e masave për shtimin e buxhetit për shtesë të një kati, me qëllim sistemimin në këtë institucion të të moshuarve të tjerë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit në vijim edhe të ndryshimeve të fundit në treg.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Shërbimi Social Shtetëror² ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1, mbi ndryshimin e organikës duke shtuar një psikolog me kohë të plotë theksojnë se organika e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë është miratuar me VKM nr. 88, datë 25.10.2010. Në lidhje me punësimin e mjekut në institucion, bazuar në Vendimin me nr. 394, datë 30.06.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1151, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të pjesshme për vitin 2021 në Njësitë e Qeverisjes Vendore””, është punësuar mjeku me kohë të pjesshme.*
- *Për rekomandimet nr.2, 3, dhe 5, Shërbimi Social Shtetëror nuk mund të akordojë fonde për investime. Sipas VKM nr. 850, datë 15.12.2006, pika 1 gërma ç “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë të pronës, e cila është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror” godina e institucionit është në varësi të Bashkisë. Vendimi citon “Institucioni dhe shërbimi shoqëror që ofrohet në të, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.”.*

¹ Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë, K4/I32-2Prot, dt.25.07.2022.

² Shkresa me nr. 1480/1 prot., date 01.08.2022.

- *Për rekomandimin nr.4*, mbi ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se në kuadër të decentralizimit, të drejtën për të ngritur shërbime dhe për rastin konkret atë socio-sanitare, është përgjegjësi e Qarkut dhe Bashkisë Gjirokastrë.

- *Për rekomandimin nr.6* Lidhur me rekomandimin për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit sipas Udhëzimit nr.689, datë: 2.10.2018 “ *Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore*”. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve kuota është 360 lekë. Sa më sipër jemi informuar se kuota ushqimore nga 360 lekë në ditë, është rritur në vlerën 430 lekë, sipas udhëzimit nr. 662, datë 06.12.2022, “Për një ndryshim në udhëzimin nr, 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, bazuar dhe në rekomandimet e njëpasnjëshme të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit konstaton se përgjigjet e Shërbimit Social Shtetëror nuk tregojnë bashkëpunim në lidhje me përmirësimin e kushteve sipas rekomandimeve. Ndërkohë është i qartë fakti që organika e qendrës miratohet me VKM, por do duhet të paraqesin kërkesë të ndryshojnë këtë VKM duke qenë autoriteti propozues.

Nga informacioni, rezultoi se ***nuk kishin gjetur zbatim*** disa nga rekomandimet e Avokatit të Popullit të lëna në inspektimin e mëparshëm:

1. Nuk ishin marrë masa për shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.

2. Nuk ishin marrë masa për shtimin e buxhetit për shtesë të një kati, me qëllim sistemimin në këtë institucion të të moshuarve të tjerë për shkak edhe të shtimit të numrit të kërkesave vitin e fundit.

3. Nuk ishin marrë masat për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Rekomandimet e zbatuara janë:

- ✓ Ishin marrë masat për bashkërendimin e punës ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Gjirokastrë për vënien në funksion të ngrohjes qendrore.

- ✓ Ishin marrë masa për rivlerësimin e kuotës ditore të ushqimit në vijim edhe të ndryshimeve të fundit në treg.

- ✓ Ishin marrë masat pjesërisht për eliminimin e lagështirës në ambientet e institucionit.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Gjirokastrë

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë, është një institucion publik rezidencial, ku trajtohen persona të moshuar, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i këtij institucioni është që të ofrojë ndihmë dhe shërbime sociale të qëndrueshme dhe me standarde bashkëkohore, me qëllim që të nxitet pavarësia dhe integrimi i të moshuarve në jetën normale, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin, me synim plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë dhe me mbështetje financiare të garantuar nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton në mënyrë periodike në Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Gjirokastrë, përsa i përket buxhetit, zbatimin e projekteve, menaxhimin e ndihmave humanitare nga donatorë të ndryshëm, paraqitjen e informacionit statistikor.

Shtëpia e të Moshuarve, Gjirokastrë, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdueshëm, monitorohet nga Bashkia Gjirokastrë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, nga inspektimet e kryera të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit etj.

Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara

Në këtë qendër strehohen të moshuar duke filluar që nga moshën 60 vjeç, por ka dhe përfitues të tjerë, të cilët vijnë si raste emergjente. Aktualisht strehoheshin 60 të moshuar dhe kapaciteti i kësaj qendre është prej 60 personash. Nga këta 5 të

moshuar janë të sëmurë me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore, të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë. Numri i personave të cilët përfitojnë pension pleqërie është 35, nga i cili 60% ju jepet vetë personave ndërkohë që 40% shkon në buxhetin e shtetit³.

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan për kujdesin shëndetësor, sipas nevojave specifike për secilin të moshuar, bazuar në kartelën shëndetësore, e cila mbahet të mjeku i familjes. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet çdo muaj nga mjekja, e cila prej vitesh punon me kohë të pjesshme në këtë institucion, e cila çdo ditë i takon të moshuarit, i mat tension dhe bisedon me ta për çdo problem që ata i shqetëson. Gjithashtu të gjithë të moshuarit kishin të pasqyruar në kartelat e tyre dhe analizat klinike dhe biokimike.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, i mbulon vetë institucioni sipas rekomandimit të mjekut.

Plani i përkujdesit për të moshuarit hartohet çdo vit, ndërsa rishikohej ecuria i të moshuarit çdo 6 muaj. Nëse konstatoheshin probleme më specifike, plani i përkujdesjes rishikohej edhe më herët.

Burimet njerëzore

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 21 punonjës ku të gjithë ishin të kualifikuar sipas pozicionit përkatës. Vlerësimi i punës bëhet çdo gjashtë muaj.

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbahen në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë, e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokastrë.

Shërbimet mjekësore realizohen nga mjeku, i cili punon me kohë të pjesshme. Spitali Rajonal Gjirokastrë herë pas here dërgon mjekë për të parë gjendjen shëndetësore të të moshuarve, sipas një akt-marrëveshjeje. Ka një plan individual për çdo të moshuar dhe secili ka kartelën e tij mjekësore. Medikamentet që marrin të moshuarit pasqyrohen në një bllok të veçantë, i cili sekretohet dhe ruhet në arshivë. Shërbimi dentar realizohet me shpenzimet e të moshuarve, por edhe nga institucioni.

³ Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime në Vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror"

Kuota ushqimore nga 360 lekë në ditë është rritur në vlerën 430 lekë, sipas udhëzimit nr. 662, datë 06.12.2022, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, bazuar dhe në rekomandimet e njëpasnjëshme të Avokatit të Popullit.

Menyja javore përcaktohet nga të moshuar, kujdestarë, punonjësja sociale, mjeku dhe kuzhinierja.

Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të këtij institucioni mbizotëron pastërtia, gjë që tregon për një bashkërendim të punës së Drejtuesit, stafit dhe përfituesve.

Për eliminimin e lagështisë në ambientet e institucionit ishte vetë institucioni që ndërhynte herë pas here me fondet e tij, por kjo nuk ishte e mjaftueshme.

Përgjatë inspektimit konstatuam se me fondet e Bashkisë Gjirokastrë Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë ishte pajisur me kondicionerë për ngrohje dhe ftohje një zgjidhje kjo për tu përshëndetur pasi janë eliminuar ngrohëset të cilat përbënin rrezik për shkaktimin e incidenteve me të moshuarit.

Të moshuarit për higjienën e tyre personale bënin dush dy herë në javë.

Me problemet psiko-sociale merret vetëm një punonjëse sociale.

Në çdo kat, në ambiente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme, standardet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës dhe të përfituesit.

Kutia e ankesave, çelësi i së cilës mbahet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, hapet në datë 1 (një) të çdo muaji, në praninë e një të moshuari.

Furnizimi me artikuj hotelerikë gjatë vitit 2023 ka qenë sipas nevojave dhe nuk ka patur mungesa.

Nga intervistimi që patëm me të moshuarit ata nuk patën ankesa ndaj shërbimit të stafit të këtij institucioni.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:

- Në organikën e punonjësve të institucionit nuk ka psikolog, i domosdoshëm të jetë i pranishëm për këto kategori përfituesish.

- Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ai i mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë çdo ditë i pranishëm në qendër, të paktën 8 orë.
- Problematikë e komunikuar edhe nga stafi i shtëpisë së të moshuarve është mungesa e një automjeti i cili është i domosdoshëm për kryerjen e lëvizjeve dhe shërbimeve ndaj të moshuarve.
- Një problem i konstatuar nga grupi i inspektimit ishte dhe pamjaftueshmëria e posteve të dusheve për ruajtjen e higjienës personale të të moshuarve. Përgjatë inspektimit të ambienteve të qendrës konstatuam se kishte 1 post dushi për 16 persona.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me psikolog dhe mjek me kohë të plotë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare për eliminimin e lagështirës në ambientet e institucionit.
3. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
4. Marrjen e masave për pajisjen e Shtëpisë të Moshuarve Gjirokastër me një automjet për kryerjen e shërbimeve ndaj të moshuarve.
5. Marrjen e masave për shtimin e posteve të dusheve për ruajtjen e higjienës personale të të moshuarve.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

AHMET PRENÇI